

YOU SEE!

PLATFORM FOR SOCIAL INNOVATIONS
IN YOUTH EMPLOYMENT




Regional CSO platform advocating social innovation under employment policies that guarantees security for youth at risks, an EU-funded project. This document has been produced by financial assistance of the EU funds of Civil Society Facility Operating Grants to IPA CSO Associations.

LEAD APPLICANT



CO-APPLICANTS



The content of this document are the sole responsibility of YOU SEE! project partnership and can under no circumstances be regarded as reflecting the position of the EU.

VETËPUNËSIMI

VETËPUNËSIMI

“LENS”
Dhjetor 2016

Ky punim është pjesë e projektit Platforma rajonale e shoqërisë civile që avokon për inovacionin social në politikat e punësimit për të garantuar gjithpërfshirje të të rinjve, është një projekt i financuar nga BE-ja. Ky material është botuar me ndihmën e fondeve të BE-së për Shoqërinë Civile Granteve IPA për Operim të OShC-ve. Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi e projekti YOUSEE! dhe nuk i paraqet në asnjë formë qendrimet e BE-së.

PËRMBAJTJA

AKRONIMET	7
PARATHËNIE	8
ABSTRAKTI	9
1. HYRJE	11
2. NDIKIMI I MASAVE AKTIVE TË TREGUT TË PUNËS NË ZBUTJEN E PAPUNËSISË	14
2.1 Mundësitë e punësimit të të rinjve përmes programit të vetëpunësimit	17
2.2 Vetëpunësimi përmes ndërmarrjeve sociale	24
3. REKOMANDIME	28
4. PËRFUNDIME	30

AKRONIMET

DPP – Departamenti i Punës dhe Punësimit

MPMS – Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale

MTI – Ministria e Tregtisë dhe Industrisë

NVM – Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme

OJQ – Organizatat Jo Qeveritare

QAP – Qendrat e Aftësimit Profesional

TIK – Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit

ZP – Zyrat e Punësimit

PARATHËNIE

Ky punim është pjesë e projektit: “Platforma rajonale e shoqërisë civile që avokon për inovacionin social në politikat e punësimit për të garantuar gjithpërfshirje të të rinjve” mbështetur nga Fondi i Komisionit Evropian për Shoqëri Civile, dhe zbatuar nga një partneritet i gjashtë organizatave nga Ballkani Perëndimor si dhe Turqia. Projekti është zbatuar në një periudhë prej 12 muajsh në Kosovë, Mal të Zi, Shqipëri, Maqedoni, Serbi, Bosnje Hercegovine si dhe Turqi. Përmbatja e këtij punimi është përgjegjsi e YOUSEE! projektit dhe në asnjë rrethanë nuk paraqet qëndrime të BE. Të dhënat këtu janë vetëm për rastin e Kosovës dhe janë mbledhur e përpunuar nga Lens.

Të dhënat e këtij punimi janë marrë nga hulumtimet, statistikat dhe raportet e institucioneve të ndryshme qeveritare dhe jo qeveritare. Dhe ka për qëllim propozimin e disa udhëzimeve që do të shërbenin si shembuj funksional për zbutjen e nivelit të lartë të papunësisë. Punime me temë të ngjashme do të gjeni në të gjitha vendet partnere të projektit. Partnerët janë koordinuar bashkërisht për aktivitetin e tyre, mirëpo hulumtimet kanë tema konkrete të veçuara në bazë të vështirësive kombëtare, dhe në tërësi do të përmyllen nga një raport regional që do të shërbej si një pasqyrë për gjendjen momentale regjionale.

Pra projekti synon të forcojë bashkëpunimin regional, përfaqësinë dhe pjesëmarrjen politike për mbështetjen e reformave efektive në politikat e punësimit, duke artikuluar kështu interesat e grupeve rinore në rrezik të marginalizimit në përputhje me prejardhjen e tyre socio-ekonomike si dhe vendbanimin.

ABSTRAKTI

Masat aktive të tregut të punës janë elementi më i rëndësishëm i përpjekjeve të një vendi për ta luftuar papunësinë. Në Kosovë këto masa përbëjnë pjesën qendrore të strategjisë sektoriale, të cilat e definojnë punësimin si një objektivë kyçe të politikës së përbashkët ekonomike. Prioritet parësor i tyre është jo vetëm sigurimi i zhvillimit të aftësive dhe mundësive të punësimit, por edhe trajtimi i problemit të papunësisë afatgjate. Qëllim kryesor në këtë studim është shpjegimi i masave aktive të tregut të punës, ndikimi i tyre në rritjen e aftësive për tregun e punës, konkretisht mbështetja e vetëpunësimit në funksion të ndërmarrësisë sociale, me qëllim të ofrimit të mundësive të punësimit për të rinjtë.

Pra, pyetja kërkimore është se si masat aktive të tregut të punës, duke u fokusuar në kombinimin mes vetëpunësimit dhe ndërmarrësisë sociale, kanë potenciale për të gjeneruar mundësi të reja punësimi dhe vetëpunësimi për të rinjtë e papunë dhe punëkërkues.

Me punësim kuptojmë të drejtën themelore të individëve për të siguruar burime të mjaftueshme jetese, në përputhje me dinjitetin njerëzor dhe sigurimin e furnizimit me mallra e shërbime plotësuese, në interes të komunitetit. Ndërsa, papunësia paraqet pjesën e forcës punëtore e cila nuk është e zënë me punë mirëpo kërkon punë në mënyrë aktive.

I vetëpunësuar është ai/ajo që kryen apo gjeneron një punë i vetëm apo me një grup njerëzish, pa qenë i kontraktuar nga punëdhënësi.

Të dhënat në studim janë marrë nga raportet, hulumtimet, statistikat e institucioneve të ndryshme qeveritare dhe jo qeveritare.

Konkluzion i studimit është se masat aktive të tregut të punës dhe vetëpunësimi në funksion të ndërmarrësisë sociale është njëra ndër alternativat kryesore për rritjen e punësimit të të rinjve.

Fjalet Kyçe: Kosova, papunësia, ndërmarrësi sociale, tregu i punës, vetëpunësimi.

1. HYRJE

Adresimi i problemeve sociale si papunësia, përfshirja sociale dhe ofrimi i shërbimeve të ndryshme në favor të shoqërisë mbetet një sfidë e madhe për vendet në zhvillim. Aktualisht, Kosova vuan nga papunësia e lartë. Objektivi i përgjithshëm social është reduktimi i varfërisë përmes rritjes së angazhimit të rinjve në vende pune, me një fokus të veçantë tek të rinjtë në rrezik të marginalizimit. Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme janë një realitet në zhvillim ekonomik të Kosovës. Ato ushtrojnë aktivitete në fusha të ndryshme, megjithatë ato përballen me disa pengesa të ndryshme në zhvillimin e biznesit. Pengesat janë nga më të ndryshmet si: barrierat kulturore, infrastrukurore, operacionale, rregullative dhe të brendshme. Mungesa e aftësive menaxheriale, burokracia, mungesa e besimit, mungesa e kapitalit për bizneset e reja si dhe të ekonomisë informate janë pengesat kryesore për zhvillimin e NVM-ve. Përfshirja sociale nuk është akoma një çështje që mund të përkrahët dhe zhvillohet brenda kuadrit ekzistues të biznesit në Kosovë.

Në Kosovë, çështja që lidhet me përfshirjen sociale dhe ofrimin e shërbimeve sociale në dobi të shoqërisë lidhet kryesisht me veprimtarinë e Organizatave jo Qeveritare (OJQ). Në Kosovë ka rreth 4882 OJQ të regjistruara, megjithatë vetëm 500 janë aktive. Nga këto OJQ gjejmë disa që janë përfshirë në aktivitete ekonomike dhe sociale në mbështetjen punësimit dhe ofrimin e shërbimeve sociale. Për shembull, OJQ-ja “Rrjeti i Grave të Kosovës” është përfshirë në zbatimin e aktiviteteve të ndryshme ekonomike për punësimin e grave apo organizatat që mbështesin sektorin social. Një tjetër shembull vjenë nga organizata “Hendikos” e cila ofron shërbime dhe punësim për

njerëzit me aftësi të kufizuara, dhe në veçanti ofron shërbime sociale për fëmijët me aftësi të kufizuara.

Kosova nuk ka akoma një rregullim specifik për ndërmarrjet sociale dhe as një institucion të dedikuar për këtë çështje. Megjithatë politikat e ndryshme sektoriale që lidhen me integrimin në punë të personave të disavantazhuar apo me ofrimin e të mirave dhe shërbimeve sociale për kategori të ndryshme janë zhvilluar në mënyrë të vazhdueshme.

Njëra nga ndërhyrjet në tregun e punës që tenton rritjen e punësimit, veçanërisht të rinjve, është masa e vetëpunësimit. Vetëpunësimi ofron shumë mundësi për punësimin e të rinjve, aftësimin e

tyre për tregun e punës, rritje të kapaciteteve si dhe zhvillimin veprimtarive të tyre të cilat rrisin potencialin e punësimit përmes zhvillimit të afarizmit.

Nxitja e vetëpunësimit përfshin dy hapa. Hapi i parë ka të bëjë me ofrimin e informacionit dhe rritjen e ndërgjegjësimit në lidhje me atë që përfaqëson vetëpunësimi, si edhe me çfarë nevojitet për të filluar dhe menaxhuar një biznes, në mënyrë që individët ta konsiderojnë/shqyrtojnë atë realisht si një mundësi karriere. Në rast se një individ vendos ta shqyrtoj me tej këtë mundësi për karrierë apo vendos të fillojë biznesin e tij/saj, hapi i dytë parashikon sigurimin e një pakete masash mbështetëse që nisin nga trajnimet për aftësitë profesionale në lidhje me biznesin deri në këshillime përpara dhe pas hapjes së biznesit, si edhe ne qasjen ndaj granteve dhe/ose kredive.

Një mundësi tjetër do të jetë një punëtori që synon të ofrojë informacion dhe të rrisë ndërgjegjësimin për atë se çka paraqet vetëpunësimi dhe se çfarë duhet të investosh për të krijuar e

menaxhuar një biznes, në mënyrë që personat të shohin konkretisht vetëpunësimin si mundësi e mirë e tyre në karrierë. Ata kandidatë që kanë karakteristikat dhe motivimin e duhur për të qenë pjesë e programit do të intervistohen individualisht dhe do të hartojnë një plan zhvillimi individual.

Rënia e ndjeshme në nivelin e pjesëmarrjes së fuqisë punëtore në tregun e punës mund të ketë shkaqe të ndryshme si për shembull një numër i konsiderueshëm personash punojnë në sektorin joformal, të tjerët mund të jenë dekurajuar nga situata e tregut t punës dhe janë larguar nga fuqia punëtore. Po ashtu, interesimi i të rinjve për marrë pjesë në masat aktive të tregut të punës ka rënë shkaku i mos efikasitetit të këtyre masave në krijimin e marrëdhënieve të rregullta të punës si dhe kompensimit që marrin gjatë kohës sa janë të angazhuar dhe që është i ultë për standardin e jetesës në Kosovë. Kompensimi aktual është i konceptuar për të mbuluar shpenzimet e udhëtimit dhe ushqimit, mirëpo kostoja e këtyre shpenzimeve është rrit disa herë, ndërsa kompensimi nuk ka reflektuar këtë rritje. Mandej ka pasur ankesa se në disa raste punëdhënësit nuk i trajtojnë si duhet të rinjtë e angazhuar në programe dhe projekte që mbështesin masat aktive të tregut të punës.

2. NDIKIMI I MASAVE AKTIVE TË TREGUT TË PUNËS NË ZBUTJEN E PAPUNËSISË

Masat aktive të tregut të punës janë intervenimet kryesore të qeverisë në tregun e punës me qëllim të ofrimit të një mundësie për punëkërkuarit në punëzënie, rritje të aftësive për tregun e punës si dhe ndërmjetësim direkt në punësim në sektorin privat. Aty ku ka pajtueshmëri mes punëkërkuarit dhe punëdhënësit; krijojnë mundësi të kontaktit direkt mes punëkërkuarit dhe punëdhënësit, njohje dhe zhvillim të raporteve të cilat në rastin më të mirë rezultojnë me krijimin e marrëdhënies së rregullt të punësimit. Gjithashtu rrisin nivelin e bashkëpunimit mes institucioneve dhe sektorit privat për punësim.

Masat aktive të punësimit luajnë një rol shumë të rëndësishëm në integrimin e personave të papunë në tregun e punës. Përmes masave aktive janë ndërmjetësuar një numër i konsiderueshëm i punësimit të personave të papunë, si dhe një numër prej tyre janë referuar në aftësime profesionale. Papunësia e të rinjve nuk është thjesht një gjendje e përkohshme që pasohet nga punësimi i të rinjve në një periudhë të mëvonshme, por përkundrazi është një proces i stërzgjatur i kalimit nga shkolla, papunësia, punësia, punësimi i papaguar, punësimi me page të ulët i forcës punëtore të pakualifikuar, e të gjitha këto kanë kosto oportune tepër të ulëta.

Vetëpunësimi është njëra ndër masat e tregut të punës e cila ndihmon të papunësuarin për nisjen e një biznesi, ose ofrimi i trajnimit dhe këshillimit të vetëpunësuarve për të zhvilluar dhe menaxhuar një biznes. Masat aktive të tregut parashohin edhe mbështetjen financiare për të ndihmuar të papunësuarit

për të nisur një aktivitet biznesi. Vetëpunësimi vazhdon të kontribuojë me rreth 21% të nivelit të përgjithshëm të punësimit dhe është alternativë ndaj punës me pagë kur ky i fundit është vështirë të arrihet.¹ Masa për vetëpunësim ka për qëllim adresimin e papunësisë përmes vetëpunësimit dhe në këtë mënyrë duke krijuar vende të reja pune në kompanitë e vogla.

Aftësimi profesional përfshin dy nënmasa, si: (i) Trajnimi institucional në Qendrat e Aftësimit Profesional, dhe, (ii) Trajnimi i kombinuar (QAP dhe kompani).

(i) Trajnimi institucional nënkupton trajnimi që ofrohet nga 8 Qendrat e Aftësimit Profesional (QAP) që operojnë nën ombrellën e Departamenti i Punës dhe Punësimit (DPP).

Qendrat për Aftësim Profesionale (QAP) ofrojnë trajnime për punëkërkuesit për një profesion të caktuar falas duke u fokusuar në aplikimin e shkathtësive dhe njohurive praktike duke përdorur mësimin në klasë dhe kabinete të ndryshme. Qëllimi i trajnimeve institucionale është që të mundësojnë një ngritje ose adaptim të njohurive profesionale, shkathtësive dhe qëndrimeve të nevojshme për performancë efikase në një profesion.

(ii) QAP do të identifikojë kompanitë për bashkëpunim dhe me marrëveshje mirëkuptimi me bizneset, do të aplikojnë trajnim të kombinuar, ku disa module zhvillohen në qendër dhe modulet e tjera të ndërlidhura me pjesën praktike të finalizimit të produktit zhvillohet në kompani.

¹ Strategjia e punësimit - http://mpms.rks-gov.net/Portals/0/Aktiviteti%20javor/Strategjia%20e%20Punesimit_Drafti%20i%20aprovuar%20nga%20Qeveria.pdf

Për të verifikuar progresin që ka bërë klienti drejt arritjes së objektivit përfundimtar të programeve të punësimit d.m.th. (ri) punësimit është e domosdoshme të krijohet një sistem monitorimi i cili lejon matjen e performacës për individët, programet dhe qarqet.

DPP-ja ka monitoruar, mbikëqyr, vlerësuar dhe realizuar politikat e punësimit dhe aftësimeve profesionale përmes Divizionit të Punësimit dhe Divizionit të Aftësimeve Profesionale.. Në analiza të ndryshme ekonomike të tregut të punës së të rinjve, një faktor përcaktues për punësimit ose papunësinë e të rinjve cilësohet edhe arsimimi.

Indikatorët kryesorë të tregut të punës (%)	Meshkuj	Femra	Totali
Shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore	61.8	21.4	41.6
Shkalla e joaktivitetit	38.2	78.6	58.4
Raporti punësim ndaj popullsisë (shkalla e punësimit)	41.3	12.5	26.9
Shkalla e papunësisë	33.1	41.6	35.3
Shkalla e papunësisë tek të rinjtë (15 - 24 vjeç)	56.2	71.7	61.0
Përqindja e të rinjve NEET në popullsinë e të rinjve (15 - 24vjeç)	26.6	34.0	30.2
Përqindja e punësimit të paqëndrueshëm ndaj punësimit të përgjithshme	26.7	18.9	24.9

Figura 1. Indikatorët kryesorë të tregut të punës (%) Burimi: Anketa e Fuqisë Punëtore në

Kosovë 2015

2.1 MUNDËSITË E PUNËSIMIT TË TË RINJVE PËRMES PROGRAMIT TË VETËPUNËSIMIT

Programi i vetëpunësimit mbështet të papunët dhe punëkërkuesit të cilët kanë dëshirë por edhe vizionin dhe strategjinë për të krijuar dhe ndërtuar bizneset e tyre. Si rezultat i krijimit të bizneseve, jo vetëm mund të vetëpunësohen, por edhe të gjenerojnë vende pune për punëkërkues dhe të papunë tjerë. Të rinjtë duhet të kërkojnë informacione për programin e vetëpunësimit tek institucionet të cilat merren me tregun e punës, si: Zyrat e Punësimit, Qendrat e Aftësimeve Profesional, organizatat rinore në nivelin lokal si dhe partnerët dhe donatorët e jashtëm që organizojnë programe dhe projekte të tilla. Trajnime profesionale lidhur me ndërmarrësin dhe vetëpunësimin mund të merren në Qendrat e Aftësimit Profesional.

Rrjeti i Qendrave të Aftësimit Profesional shtrihet në regjionet kryesore të Kosovës dhe ofrojnë trajnime për të papunë apo punëkërkues të cilët dëshirojnë të trajnohen apo ri trajnohen lidhur me profesionet të cilat kërkohen nga tregu i punës. Zyrat e Punësimit të cilat funksionojnë në kuadër të MPMS-së ofrojnë këshillime lidhur me vetëpunësimin apo ndërmarrësin duke filluar nga këshillimet për zgjedhjen e idesë për plan biznesi, mentorime lidhur me zhvillimin e ndërmarrjes, dhe informata tjera relevante lidhur me vetëpunësim.

Mund të themi se nuk ka një treg të mirëpërcaktuar për të rinjtë. Ka vetëm një diferencim midis punëve që janë më të përshtatshme për të rinj energjikë dhe punëve që kërkojnë një kualifikim më të mire dhe përvojë më të gjatë nga anën e punëtorëve.

Andaj, vetëpunësimi është dizajnuar që të mbështesë krijimin e veprimtarive të qëndrueshme afariste apo kompanive që janë në gjendje të arrijnë sukses në tregje konkurruese. Masat aktive të tregut të punës të cilat implementohen në Kosovë janë:

1. Vetëpunësimi,
2. Praktika në punë,
3. Trajnimi në punë,
4. Aftësimi profesional,
5. Punët publike.

Këto masa aktive të tregut të punës janë implementuar nga institucione dhe donatorë të ndryshëm në forma dhe modalitete të ndryshme. Deri tani nuk kemi pasur një kornizë institucionale të pranuar dhe zbatuar gjerësisht se si duhet të procedohen dhe implementohen masat aktive të tregut të punës. Mungesa e kësaj kornize ka prodhuar rezultate të ndryshme të cilat jo vetëm që nuk kanë qenë në funksion të njëra tjetrës, por disa herë kanë krijuar edhe konfuzitet. Megjithatë ekziston një besim i përgjithshëm se prej të gjitha masave aktive të tregut të punës, vetëpunësimi deri tani ka qenë masa më e suksesshme në punësimin e të rinjve.

Një strategji kombëtare e punësimit do të ishte një mundësi e mirë për Kosovën, do të paraqiste politikat e tregut të punës të cilat do të ishin në harmoni me Strategjinë Ekonomike Evropiane “Evropa 2020”, dhe të kishte për qëllim të ofrojë masa specifike për uljen e papunësisë së strukturuar. Strategjia do të kontribuonte në zhvillimin e një fuqie punëtore që është në përputhje me kërkesat e tregut të punës, adoptimin e një sistemi për edukim dhe trajnim si dhe luftimin e ekonomisë jo-

formale. Më konkretisht, kjo strategji do të synonte arritjen e këtyre objektivave përmes programeve të më poshtme:

- Programi shtesë i punësimit përmes granteve deri në 1.500 euro për çdo person të ri të papunë, punësime të reja për periudhën 2016-2020 në firmat që janë të regjistruara me mekanizma të vetëpunësimit;
- Programi për përgatitje për punësim përmes trajnimeve, rrikualifikimeve apo më shumë kualifikim për personat e papunësuar, me qëllim të pajisjes me njohuri dhe shkathtësi;
- Programi i trajnimit për disa profesione që janë deficitare në tregun e punës.

Strategjia evropiane e punësimit synon të krijojë më shumë vende pune dhe bazohet në strategjinë e përgjithshme për zhvillim të njohur si “Evropa 2020”. Ky dokument përmban pesë objektiva kryesore që kanë të bëjnë me punësimin, inovacionin, edukimin, përfshirjen sociale, dhe energjinë që synohen të arrihen deri më 2020.²

Programi i vetëpunësimit është program konkurrues për të garantuar kthimin më të lartë të mundshëm të investimit. Vetëpunësimi aplikohet si masë aktive e tregut të punës për ta nisur një veprimtari biznesi apo mundësi për t’u bërë i vetëpunësuar. Ai përfshin trajnimin/këshillimin, mbështetjen financiare dhe shërbimet këshilluese për personat e papunë me kualifikime dhe shkathtësi të tjera për të qenë të suksesshëm në bizneset e tyre.

² European Commission, Europe 2020: Europe’s Growth Strategy, <http://ec.europa.eu/social/main.jsp?langId=en&catId=956>

Elementet kryesore të një programi të suksesshëm të vetëpunësimit përfshijnë një proces të drejtë dhe konkurrues të aplikimit, trajnime në shkathtësi themelore të biznesit, përgatitjen e një plani të qëndrueshëm e të realizueshëm të biznesit, mbështetje financiare (përmes sigurimit të granteve) për të nisur një biznes dhe mentorim dhe këshillim me shërbime për biznese. Programi i ndërmarrësisë dhe vetëpunësimit mund të marrë formë të mbështetjes direkte apo indirekte, siç janë:

- Këshillimi për ngritjen e motivimit për punësim, përkatësisht vetëpunësim; dhe,
- Shërbimet e mbështetjes, mentorimi dhe këshillimi.

Trajnimi për ofrimin e vlerave dhe bazave të fillimit të udhëheqjes së biznesit ngërthen në vete edhe hartimin e planit bankar që lidhet me biznesin. Parasegjithash përkrahja për programin e vetëpunësimit konsiston në përkrahjen financiare për jetësimin e biznes planit e cila nëse gjykohet nga programet dhe projektet e veçanta të implementuara në Kosovë nga donatorë të ndryshëm ka ndryshuar dhe nuk ka qenë asnjëherë unike apo e njëjtë varësisht nga mundësitë financiare të institucioneve të cilat i kanë implementuar projektet.

Dikush që ka përfituar prej programeve dhe projekteve të cilat kanë promovuar vetëpunësimin apo ndërmarrësin në shumicën e rasteve kanë qenë të përjashtuar nga mundësia e ri aplikimit për një program apo projekt i cili po ashtu e ka pasur vetëpunësimin si masë aktive të tregut të punës pavarësisht se nga cili donator është implementuar. Institucionet e ndryshme shtetërore kanë kapacitete të ndryshme se si mund të përkrahin programet dhe projektet e vetëpunësimit. Qendrat e Aftësimin Profesional programin e vetëpunësimit e përkrahin

përmes trajnimeve dhe ri trajnimeve nga fusha e ndërmarrësisë.

Institucionet e edukimit fillor dhe të mesëm programin e vetëpunësimit mund ta përkrahin duke e inkorporuar brenda kurikulave shkollore me qëllim të aftësisë të rinjve për tregun e punës dhe duke rritur aftësinë e tyre konkurruese në ndërmarrësi. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë programin e vetëpunësimit mund ta përkrah duke liruar nga obligimet financiare fillestare bizneset të cilat si fokus kryesor kanë rritjen e punësimit apo vetëpunësimin. Zyrat e Punësimit vetëpunësimin mund ta përkrahin përmes shërbimeve të këshillimit dhe mentorimit për përzgjedhjen e bizneseve të cilat kërkohen në treg dhe që me pak investime mund të gjenerojnë vende të reja pune.

Në përgjithësi fokusi kryesor institucional për programin e vetëpunësimit, në rrethana kur mundësitë financiare janë të kufizuara, duhet të orientohet drejt targetimit të punëkërkuesve dhe të papunëve, veçanërisht atyre që janë punëkërkues dhe të papunë afatgjatë, në fokus të veçantë të rinjtë, dhe gratë. Këto kategori përballen me hyrjen më të madhe në papunësi dhe mundësi të kufizuara për punësim. Prandaj është me rëndësi që fondet shtetërore të orientohen në drejtim të përkrahjes së punësimit të këtyre punëkërkuesve. Nga përvoja e deritanishme e implementimit të programeve dhe projekteve të vetëpunësimit në Kosovë mund të konkludojmë se, të gjitha biznes idetë nga secili sektor ekonomik mund të aplikojnë për këtë programin.

Megjithatë, disa ide të biznesit të cilat janë të pa pranueshme për të marrë pjesë në program janë:

- Të gjitha llojet e veprimtarive në kuadër të sektorit primar të bujqësisë ose blegtorisë;
- Veprimtaritë me patundshmëri, lizing;
- Veprimtaritë financiare dhe të sigurimeve dhe veprimtaritë që përfshijnë bixhozin;
- Prodhimi i pijeve me përmbajtje të lartë të alkoolit dhe rakisë;
- Prodhimi i produkteve të duhanit;
- Prodhimi dhe shpërndarja e armëve;
- Prodhimi që përdor teknologji që çojnë në ndotje të mjedisit (të ajrit, ujit, tokës etj.);
- Bizneset joformale; dhe,
- Aktivitete biznesore nën sektorët e tregtisë.

Ndërsa aktivitetet e biznesit që kanë pasur prioritet kanë qenë në gjashtë sektorët e mëposhtëm ekonomikë, të përzgjedhura nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI), që kanë potencial më të lartë për rritje ekonomike në Kosovë, të identifikuar nëpërmjet këtij vlerësimi në bazë të mjedisit të sektorit privat në rajon, si:

- Përpunimi i ushqimit dhe industria e paketimit, me fokus në përpunimin e mishit;
- TIK krahas me kontraktimin e jashtëm të proceseve të Biznesit dhe sektori i qendrave të mbështetjes për konsumatorë;

- Ndërtimtaria;
- Industria e përpunimit të metalit;
- Industria e tekstilit; dhe,
- Industria e përpunimit të drurit dhe bizneset pyjore.

Sa i përket masave aktive të tregut të punës sfidë mbetet numri i vogël i përfituesve. Shembull në vitin 2015 në masat aktive të tregut të punës kanë marrë pjesë gjithësej 7180 përfitues. Kjo shifër nëse krahasohet me shkallën e përgjithshme të papunësisë është e vogël për të adresuar numrin e madh të hyrjeve në tregun e punës të punëkërkuesve të rinjë.³

³ Puna dhe Punësimi (Raporti vjetor 2015) MPMS - http://mpms.rksgov.net/Portals/0/ShpalljePublikime/raporti_shqip_20.12.2016.pdf

2.2 VETËPUNËSIMI PËRMES NDËRMARRJEVE SOCIALE

Një dimension i veçantë i programeve dhe projekteve të vetëpunësimit është kur këto programe dhe projekte për vetëpunësim janë në funksion të ndërmarrësisë sociale. Ndërmarrjet sociale janë person juridik të cilat pavarësisht formës së themelimit të tyre, në aktin e themelimit kanë caktuar objektiva sociale, ato mund të zhvillojnë aktivitete të veprimtarive ekonomike, realizojnë prodhimin e të mirave materiale dhe të shërbimeve në interes të përgjithshëm të shoqërisë si dhe integrojnë në punë persona nga grupet e cenuara.

Punonjësit e ndërmarrjeve sociale janë personat të cilët punësohen dhe përfitojnë nga shërbimet dhe të mirat e ndërmarrjes sociale, bazuar në një marrëdhënie kontraktuale apo çdo formë tjetër ligjore në një afat jo më pak se një vit të caktuar. Ndërmarrjet sociale janë instrumente të promovimit të ekonomisë sociale të cilat konsiderohen si një bashkim i promovimit të vlerave sociale me sipërmarrjen e lirë. Ndërmarrjet sociale mund të kryejnë veprimtari ekonomike, por nuk themelohen konkretisht për qëllime fitimi. Qëllimi i themelimit të tyre është për të përmbushur objektiva sociale që lidhen me integrimin në punë të personave të cenuar ose me ofrimin e të mirave dhe shërbimeve në dobi të shoqërisë.

Vetëpunësimi në funksion të ndërmarrësisë sociale duhet të ofrojë mundësi përfitimi për të gjithë punëkërkuarit dhe të papunët të interesuar për punë, të cilët kanë ide biznesi dhe nuk kanë mundësi për të filluar një biznes të vogël ose të pavarur. Ku qëllimi i së cilës do të ishte gjenerimi i vendeve të reja të punës të qëndrueshme ku mund të punësohen të rinjtë apo të zgjerojnë biznese të reja të pavarura nga biznesi fillestar.

Punëkërkuessit dhe të papunët personalisht duhet të jenë të përfshirë në të gjitha fazat e inicimit dhe zhvillimit të planeve të bizneseve përfshirë këtu edhe komponentën e trajnimeve. Për më tepër punëkërkuessit dhe të papunët të cilët targetohen përmes programeve dhe projekteve të vetëpunësimit duhet të përzgjidhen në partneritet me Zyrat e Punësimit, por edhe me ofruesit jo publik të shërbimeve të punësimit. Veçanërisht ofruesit jo publik të shërbimeve të punësimit ofrojnë mundësi më të mëdha për punëkërkuessit dhe të papunët e rinjë.

Mundësi të aplikimit duhet të kenë edhe punëkërkuessit dhe të papunët tjerë të rinjë, por ata duhet të legalizojnë statusin e tyre të papunë përmes procesit të regjistrimit dhe evidentimit të ofruesit publik ose jo publik të shërbimeve të punësimit. Paraprakisht që programet dhe projektet e vetëpunësimit të jenë të suksesshme duhet të ketë një proces të informimit publik me qëllim të mobilizimit dhe njoftimit të rinjve për këto programe dhe projekte, si dhe të rritet konkureshmëria në mesin e plan bizneseve me të cilat duhet të aplikojnë të rinjtë.

Nga programet dhe projektet e vetëpunësimit nuk duhet të përfitojnë punëkërkuessit dhe të papunët të cilët:

1. Nuk janë të regjistruar dhe evidentuar si të papunë dhe punëkërkuess te ofruesit publik dhe jo publik te shërbimet e punësimit;
2. Që janë në konflikt interesi me palë dhe persona tjerë të përfshirë në procesin e vendimmarrës në përzgjedhjen dhe selektimin e plan bizneseve më të suksesshme në kuadër të programeve dhe projekteve të vetëpunësimit;
3. Që kanë përfituar nga programet dhe projektet e vetëpunësimit të implementuara nga donatorë tjerë;

4. Si dhe të gjithë ata të cilët kanë një biznes të regjistruar në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve.

Përparësi aplikimi dhe përfitimi nga programet dhe projektet e vetëpunësimit të kenë:

1. Punëkërkuesit dhe të papunët e riijnë dhe gra;
2. Punëkërkuesit dhe të papunët afatgjatë (që janë 12 muaj e më shumë të papunë);
3. Përfituesit e asistencës sociale të cilët kanë potenciale për tu transferuar nga skemat e asistencës sociale në punësim të qëndrueshëm;
4. Gratë vetë ushqyese;
5. Gratë e viseve të thella rurale dhe me mundësi të kufizuara në tregun e punës;
6. Personat me aftësi të kufizuar;
7. Pjesëtarët e pakicave etnike; dhe,
8. Punëkërkuesit dhe të papunët që kanë probleme familjare dhe sociale.

Procesi i zgjedhjes dhe selektimit të plan bizneseve më të suksesshme për vetëpunësim duhet të jetë proces i përshkallëzuar për të marrë në konsideratë potencialet më të mira të aplikuarve, por edhe të plan bizneseve. Disa nga kriteret kryesore që kërkohen janë: vlerësimi i aftësive të aplikuesve për të paraqitur dhe mbrojtur plan biznesin, rëndësia e produkteve dhe shërbimeve të cilat do t'i ofrojë biznesi dhe vlerësimi i konkurrueshmërisë, si dhe inputet e nevojshme njerëzore,

fizike dhe financiare për zhvillimin e biznesit të cilat janë në dispozicion.

Aplikuesit me potenciale më të mëdha për të përfituar nga skema duhet t'i nënshtrohen një procesi të trajnimit për ndërmarrësi, pastaj duhet të kenë mundësi të rishikojnë planet e tyre të bizneseve dhe krejt në fund të bëhet përzgjedhja e plan bizneseve më të suksesshme në partneritet me organizatat e punëdhënësve.

3. REKOMANDIME

Rekomandimet kryesore lidhur me programet dhe projektet e vetëpunësimit janë si vijon:

1. Qeveria dhe ministritë e linjës duhet të ndajnë buxhet të veçantë për çdo vit lidhur me implementimin e programeve dhe projekteve për vetëpunësim. Institucionet duhet të krijojnë një fond të veçantë për përkrahjen e programeve dhe projekteve për vetëpunësim duke zgjedhur për përkrahje idetë më të suksesshme të të rinjve të papunësuar. Programet dhe projektet e vetëpunësimit kanë potenciale të mëdha për absorbimin e të rinjve të papunë;

2. Programet dhe projektet e vetëpunësimit duhet të targetojnë angazhimin e punëkërkuësve dhe të papunëve afatgjatë, të rinjë, personat me aftësi të kufizuar, pjesëtarët e komuniteteve pakicë, si dhe vajzat dhe gratë. Këto grupe të marginalizuara shoqërore përballen me vështirësitë më të mëdha për tu integruar në tregun e punës, andaj institucionet shtetërore, përmes programeve dhe projekteve të vetëpunësimit, duhet të adresojnë krijimin e mundësive për punësim;

3. Programet dhe projektet për vetëpunësim duhet të kenë të gjitha komponentët si masa aktive e tregut të punës, duke filluar nga ofrimi i trajnimeve për aftësitë dhe shkathtësitë të cilat duhet t'i kenë punëkërkuësit dhe të papunët të cilët përfitojnë grante për start-up, mentorim lidhur me përzgjedhjen e vepërimtarisë ekonomike ku dojnë të angazhohen me plan biznes, pastaj mentorim të vazhdueshëm lidhur me zhvillimin e planit të biznesit, si dhe monitorim se si po zhvillohet vetëpunësimi;

4. Kurikulat e sistemit të edukimit formal dhe jo formal duhet të përmbajnë mësimet për të rinjtë për të vendosur kulturën e

vetë punësimin dhe ndërmarrësisë. Të rinjtë duhet të socializohen me idenë e ndërmarrësisë që nga shkolla fillore. Intervencimet e hershme në sistemin fillor të edukimit ulin gjasat që ata të mbesin të papunë kur arrijnë moshën 15, përkatësisht 18 vjeç dhe hyjnë në tregun e punës. Prandaj, institucionet duhet të intervenojnë qysh në rininë e tyre të hershme për tu siguruar se ndërtimi i karrierës së tyre është në harmoni me tregun e punës;

5. Të krijohen lehtësi financiare dhe tatimore për bizneset të cilat janë produkte të start-up dhe që punësojnë të rinjtë. Pra, vetëm bizneset të cilat kanë për qëllim kryesor punësimin të lirohen nga obligimet tatimore për periudha të kufizuara kohore deri sa të bëhen të qëndrueshme në treg. Po ashtu, të ofrohen skema të ndryshme të këshillimit, informimit dhe përkrahjes.;

6. Të adaptohen praktika dhe modele nga shtetet e rajonit dhe shtetet e Evropës Perëndimore se si programet dhe projektet e vetëpunësimin mund të jenë në funksione të ndërmarrësisë sociale. Këto praktika mund të shpërndahen përmes vizitave studimore në shtetet tjera, organizimit të konferencave dhe punëtorive të përbashkëta, si dhe hartimit të përmbledhjeve të shkurtra informuese me shembuj të suksesshëm të cilat pastaj do t'ju shpërndahen të rinjve se si mund të zhvillojnë idetë e tyre biznesore.

4. PËRFUNDIME

Gjatë këtij punimi, jemi munduar të shpjegojmë se punësimi dhe papunësia janë dy veçoritë kryesore të tregut të punës. Punësimi mund të ndodhë përmes vendosjes së marrëdhënies së punës, përmes vetë-punësimit apo përmes inkuadrimit në një biznes familjar. Andaj, krijimi i vendeve të lira të punës duhet të jetë në fokus të krijuesve të politikave dhe strategjisë së zhvillimit të Kosovës. Papunësia shkakton zhvlerësimin e kapitalit human, veçanërisht në mesin e të rinjve, që mund të jetë një nga sfidat kryesore të tregut të punës në Kosovë.

Qëllimi i shpjegimit të politikave aktive e tregut të punës përfshinë futjen e masave aktive të tregut të punës dhe programet që synojnë përmirësimin e funksionimit të tregut të punës dhe që janë të drejtuara kah individët e papunësuar dhe të pakualifikuar. Politikat pasive kanë për qëllim sigurimin e një standardi minimal të jetës për të papunët. Kjo nënkupton ndarjen e një shume të caktuar të parave që mbulon koston e jetesës për ata persona që kanë mbetur pa punë derisa të gjejnë punë. Politikë aktive e tregut të punës në përgjithësi mund të përshkruhet çdo lloj intervenimi në tregun e punës që mbështet krijimin, promovimin, vendosja në punë dhe mbajtja e punësimit.

Në përfundim mund të themi se, elementet kryesore të një programi të suksesshëm të vetëpunësimit përfshijnë një proces të drejtë dhe konkurrues të aplikimit, trajnime në shkathtësi themelore të biznesit, përgatitjen e një plani të qëndrueshëm e të realizueshëm të biznesit, mbështetje financiare (përmes sigurimit të granteve) për të nisur një biznes dhe mentorim dhe këshillim me shërbime për biznese.

www.ngolens.org